



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

**Shpallja e rezultatit të procedurës konkurruese për ndërtimin e HEC-it
“Poçem”**

Komisioni i dhënies me koncesion për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin tek Autoriteti Kontraktor të hidrocentralit “Poçem” ka përmbyllur procedurën e garës duke shpallur fitues bashkimin e dy shoqërive turke “Ayen Enerji Anonim Şirketi” dhe “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm San Ve Tic Ltd.Şti”.

Në zbatim të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar; VKM nr.575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik-privat”; VKM nr.576, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet” dhe të Dokumentave Standarte të koncesionit, Komisioni ka administruar ofertën e vetme të paraqitur nga bashkimi i dy shoqërive duke verifikuar dokumentacionin ligjor dhe atë ekonomiko-financiar, proces i asistuar nga “Mercados”, konsulenti i përzgjedhur nga BERZH.

Gara u zhvillua përmes një tenderi të hapur ndërkombëtar dhe të njoftuar në një gazetë ndërkombëtare për një periudhë 7 ditësh.

Në përfundim të vlerësimit, Komisioni klasifikoi Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm San Ve Tic Ltd.Şti” dhe “Ayen Enerji Anonim Şirketi”, si ofertë të vetme dhe e shpalli atë fituese të procedurës konkurruese.

Hidrocentrali ka një vlerë investimi të parashikuar mbi 100 milion euro, prodhimin e energjisë parashikohet të arrijë në 305,393,504 kWh; fuqia e instalizuar 99,500 kW ndërsa koha e zbatimit të punimeve 36 muaj pas marrjes së lejes së ndërtimit.

Karakteristikat e hidrocentralit:

- Prodhimi i energjisë elektrike 305,393,504 kWh
- Fuqia e vendosur 99,500 kW
- Koha e zbatimit të punimeve 36 muaj
- Vlera e investimit (pa TVSH) 14,134,724,113 Lekë / 100,962,315 €